



Projektligji “Për krijimin e Autoritetit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve”

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Postuar më: 07.08.2019

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka iniciuar projektligjin “Për krijimin e Autoritetit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve”. Qëllimi i këtij projektligji është krijimi i Autoritetit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve hekurudhore dhe detare.

Ky projektligj ka si objekt përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit, si dhe marrëdhëniet e tij me autoritetet e tjera hekurudhore dhe detare. Qëllimi i investigimit është përmirësimi, kur është e mundur, i sigurisë hekurudhore në funksion të parandalimit të aksidenteve e të incidenteve. Investigimi sipas këtij ligji nuk ka si objekt kryesor përgjegjësinë apo pjesëtimin e fajit por zbulimin e shkaqeve dhe përmirësimin e tyre.

Hapja e sigurtë e tregut hekurudhor dhe zhvillimet teknologjike për një transport ndërveprues të sigurisë së lartë, të cilët kërkojnë garantimin e përputhshmërisë teknologjike nga pikpanja e sigurisë teknike, sidhe rritja e nivelit të kësaj garancije, kërkojnë krijimin e një organi Investigimi të pavaruar nga aktorët që e krijojnë aksidentin apo incidentin për ti bërë një analizë të hollësishme të natyrave teknike apo psikologjike, pra për shkaqe materiale dhe subjektive.

Përsa më sipër, ftohen grupet e interesit të dërgojnë komentet/rekomandimet brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit dhe konsultimit publik.

Dokumenta:

- [Projektligji](#)
- [Relacioni](#)
- [Raporti i Vleresimit te Ndikimit](#)

Diskutimet
